VENDIM
Nr. 325, datë 27.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 205, DATË 9.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA HAPJA DHE NDËRTIMI I UNAZËS VERIORE, SEGMENTI A-B, NË LAGJEN "11 NËNTORI", HAPJA DHE SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË UNAZËS SË BRENDSHME, SEGMENTI QË BASHKON RRUGËN "28 NËNTORI" ME RRUGËN "RINIA", SI DHE HAPJA E SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË RRUGËS "LEF NOSI", LAGJJA "5 MAJI", SEGMENTI B-C, TË BASHKISË SË ELBASANIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën e të shpronësuarve, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 205, datë 9.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

"Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pronarin Adem Sadi Shabani, ndryshon dhe bëhet 9 660 998.5 (nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë pesë) lekë, nga të cilat:

a) Tokë "truall", me sipërfaqe 149 (njëqind e dyzet e nëntë) m^2, me vlerë 1 972 015 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëmbëdhjetë) lekë;

b) "Banesë", me sipërfaqe 211.9 (dyqind e njëmbëdhjetë pikë nëntë) m^2, me vlerë 7 620 984 (shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë;

c) "Dru frutorë" në vlerë 68 000 (gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë", sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR. 205, DATË 9.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

(Segmenti nga kryqëzimi me rrugën "Ibrahim Dinçi" deri në bashkim me Unazën Veriore segmenti "B-C"), ZK 8525

Është në VKM

Nr.	**Familja që shpronësohet**	**Nr. pas.**	**Vërt. pronësisë truall**	**banese**	**Sip. tr. shp.**	**Vlera lekë/ m^2**	**Vlera lekë**	**Sip. e banesës që preket**	**shp.**	**Vlera lekë / m^2**	**Shuma lekë Shp. ban**	**Druf rutore lekë**	**Shuma shprons. banesë + truall+ dru**	
1	Adem Sadi Shabani	13/204	258.6	211.9	149	13235	1972015	18.11	18.11	35965	651326.15	68000	2691341.15	Likujd. nga bashkia
	Bëhet													
1	Adem Sadi Shabani	13/204	258.6	211.9	149	13235	1972015	18.11	211.9	35965	7620983.5	68000	**9660998.5**	